



Punojmë apo bëjmë sikur?

PRODUKTIVITETI I PUNONJËSVE NË SHQIPËRI

RAPORT MONITORIMI

Korrik 2025

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
ILIR BRASHA

PËRMBAJTJA:

HYRJE	3
1. PRODUKTIVITETI NË SHQIPËRI KUNDREJT VENDEVE TË TJERA	5
1.1 Produktiviteti i punonjësve, krahasimi mes Shqipërisë dhe vendeve të rajonit	5
1.2 Produktiviteti në Shqipëri vs vendet e fundit të anëtarësuar në BE dhe mesatarja e BE	6
2. PRODUKTIVITETI SIPAS TË ARDHURAVE NETO TË KRIJUARA PËR PUNONJËS	7
2.1 Produktiviteti i të ardhurave neto të ndërmarrjes sipas numrit të punonjësve	7
2.2 Produktiviteti sipas viteve	8
2.3 Produktiviteti sipas aktivitetit ekonomik	9
2.4 Produktiviteti sipas aktivitetit ekonomik dhe numrit të punonjësve për ndërmarrje	10
3. PRODUKTIVITETI DHE KOSTOT NË SHQIPËRI SIPAS AKTIVITETEVE EKONOMIKE NDËR VITE	12
3.1 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik "Prodhuesit e të mirave"	12
3.2 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik "Industria nxjerrëse"	13
3.3 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik "Industria përpunuese"	14
3.4 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik "Energji elektrike, gaz, ujë dhe trajtimi i mbetjeve"	15
3.5 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik "Ndërtimi"	16
3.6 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik "Prodhuesit shërbimeve"	17
3.7 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik "Tregtia"	18
3.8 Produktiviteti dhe Kosto në aktivitetin ekonomik "Akomodimi dhe shërbimi ushqimor"	19
3.9 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik "Transporti, informacioni dhe komunikacioni"	20
3.10 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik "Shërbimet"	21
GJETJET KRYESORE	23
REKOMANDIME	25
REFERENCA	25



HYRJE

Produktiviteti i punonjësve është një nga pikat kyçe për zhvillimin dhe ecjen përpara të ekonomisë së një vendi. Pagat janë të lidhura në formë të drejtëpërdrejtë me produktivitetin. Rritja e produktivitetit të punonjësve përgjithësisht shoqërohet me rritje page, gjenerim më të madh të ardhurash për kompaninë, një ambient më të mirë biznesi e për pasojë një rritje të Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Duke shikuar rëndësinë që ka produktiviteti në pagat e punonjësve dhe në ekonominë në tërësi, ky raport ka për synim që të analizojë produktivitetin e punonjësve në Shqipëri ndër vite si dhe të bëjë një krahasim me vendet e tjera të ngjashme apo me ato që duam arrijmë. Kjo është realizuar nëpërmjet të dhënave zyrtare të marra nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) si dhe të dhëna të gjeneruara nga INSTAT.

Produktiviteti është një indikator që vlerësohet çdo vit nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, përcaktuar si output i krijuar për një orë nga një punonjës. Rezulton që në Shqipëri produktiviteti për një punonjës është vetëm 19.5\$ për orë pune. Ky është niveli më i ulët në rajon, duke qëndruar edhe pas Bosnjë Hercegovinës me rreth 7\$ më pak. Vendi me normën më të lartë të produktivitetit të vlerësuar nga ILO për vitin 2025 është Mali i Zi, ku një punonjës prodhon rreth 37.5\$ për orë.

Në këtë raport nuk kemi qëndruar vetëm tek të dhënat e ILO-s, por kemi analizuar edhe produktivitetin e punonjësve duke e llogaritur atë si të ardhurat neto të krijuara nga një kompani kundrejt numrit të punonjësve, kjo për tërësinë e tregut. Rezultatet janë shikuar në forma të ndryshme duke u ndalur tek ato të produktivitetit sipas numrit të punonjësve për ndërmarrje, produktivitetit ndër vite, produktivitetit sipas aktiviteteve ekonomike dhe numrit të punonjësve për ndërmarrje.

Rezulton që në Shqipëri produktiviteti më i lartë është në rastin e ndërmarrjeve me 10-49 punonjës, ku një punonjës krijon rreth 9.97 milionë lekë, ose rreth 100 mijë euro të ardhura neto për kompaninë në të cilën ai punon përgjatë një viti. Mesatarisht një i punësuar ka një produktivitet prej 6.04 milionë lekë në vit, ose rreth 60 mijë euro. Tendenca e produktivitetit duket rritëse me rritjen e numrit të punonjësve deri në ndërmarrjet me 50 punonjës, ndërkohë që për ndërmarrjet me mbi 50 punonjës, shfaqet dobja marxhinale rënëse, ku me rritjen e numrit të punonjësve bie produktiviteti.

Deri në vitin 2021, produktiviteti ka qëndruar në po të njëjtat shifra, ndërkohë që në vitet 2021 dhe 2022 ka shënuar përmirësime, të cilat nuk janë ndjekur në vitin 2023, vit i cili ka shënuar rënie krahasuar me vitin e kaluar.



Aktiviteti ekonomik i tregtisë është ai në të cilin krijohen të ardhurat më të larta neto për punonjës përgjatë një viti, përkatësisht në vitin 2023, produktiviteti rezulton rreth 11.23 milionë lekë ose rreth 112.3 mijë euro. Aktiviteti ekonomik i dytë me produktivitetin më të lartë për punonjës është "Energjia elektrike, gasi, uji dhe trajtimi i mbetjeve", aktivitet i cili prodhon rreth 11.06 milionë lekë ose rreth 110.6 mijë euro për punonjës gjatë një viti. Aktivitetet ekonomike që kanë një produktivitet më të ulët krahasuar me të tjerët janë "Akomodimi dhe siguria ushqimore" dhe "Shërbimet" me përkatësisht të ardhura neto për punonjës në vit 2.16 dhe 2.99 milionë lekë, ose 21.6 mijë dhe rreth 30 mijë euro në vit për punonjës.

Ndërmarrjet që kanë 1-4 punonjës në aktivitetin e "Energjisë elektrike, gazit, ujit dhe trajtimit të mbetjeve" janë ato që kanë një produktivitet më të lartë, me përkatësisht 37.72 milionë lekë ose rreth 377 mijë euro në vit për punonjës.

Për të shkuar më tej në analizë, kemi shikuar produktivitetin ndër vite për secilin aktivitet ekonomik si dhe kemi shikuar edhe koston për punonjës. Kostoja mesatare vjetore për punonjës është vlerësuar si shpenzimet e personelit që kompanitë kanë kryer kundrejt numrit të punonjësve. Këtu duhet të kemi parasysh që punonjësit janë edhe ata të deklaruar, por pa pagë, siç mund të jenë në bizneset familjare, pra në ndërmarrjet e vogla.

Rezulton që përgjithësisht ecuria për secilin nga aktivitetet ekonomike ka qenë pozitive në rritjen e produktivitetit në vitet 2021 dhe 2022, por jo në të gjitha aktivitetet është shënuar rritje gjatë vitit 2023. Në aktivitetet e "prodhuesve të të mirave", "Industrië nxjerrëse", "Industrië përpunuese", "Energjisë elektrike, gazit, ujit dhe trajtimit të mbetjeve", si dhe në "Transport, informacion dhe komunikacion" kemi një rënie të produktivitetit gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë ajo çfarë ka ndodhur me kostot për punonjës është që ato kanë shënuar rritje përgjatë 3 viteve të fundit të marra në shqyrtim për të gjitha aktivitetet ekonomike. Kosto më e lartë për punonjës është në "industrinë nxjerrëse" me përkatësisht 1.33 milionë lekë ose rreth 13.3 mijë euro në vit për punonjës dhe në aktivitetin e transportit, informacionit dhe komunikacionit ku kosto vjetore për punonjës është 0.98 milionë lekë ose rreth 9800 euro në vit. Kostot mesatare vjetore për punonjës shfaqen më të ulëta në aktivitetin e akomodimit dhe sigurimit shoqëror.

Indikatorët e produktivitetit tregojnë që produktiviteti në Shqipëri është shumë larg vendeve të BE-së, por jo vetëm, sepse Shqipëria ndodhet e fundit edhe në rajon me diferencë të lartë edhe me shtete që janë më larg sesa Shqipëria në proceset e integritimit në BE siç është Bosnje & Hercegovina. Po ashtu, shikohet që edhe produktiviteti i matur si të



ardhura neto vjetore për punonjës tregon që ka diferenca të larta midis sektorëve ekonomik, ndërkohë që pagat nuk shikohen që të kenë diferenca aq të larta (kostot në këtë rast).


1. PRODUKTIVITETI NË SHQIPËRI KUNDREJT VENDEVE TË TJERA

Në këtë seksion do të analizohen të dhënat për produktivitetin në Shqipëri krahasuar me vendet e rajonit si dhe vendet e fundit të anëtarësuar në Bashkimin European. Po ashtu krahasimi do të bëhet edhe me mesataren e Bashkimit European. Ecuria do të tregohen ndër vite. Produktiviteti për orë punë mestarisht në BE vlerësohet rreth 71.3\$ për punonjës.

1.1 Produktiviteti i punonjësve, krahasimi mes Shqipërisë dhe vendeve të rajonit

Produktiviteti i punonjësve për një orë pune përkthyer në output, përkatësisht në Prodhimin e Brendshëm Bruto të vlerësuar sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse me çmime konstante të vitit 2021 ka ndryshuar relativisht pak në 20 vite. Përkatësisht kemi një rritje të produktivitetit nga 10.64\$ për orë në vitin 2005 në 19.5\$ për orë në vitin 2025. Problematika qëndron në faktin se Shqipëria shfaq nivele më të ulëta të produktivitetit krahasuar me të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (për Kosovën nuk ka të dhëna ILO). Një punonjës në Shqipëri për një orë prodhon pothuajse 7\$ më pak sesa në Bosnje & Hercegovinë, 9.3\$ më pak sesa në Serbi, 14\$ më pak sesa në Maqedoninë e Veriut dhe 18\$ më pak sesa në Mal të Zi.

Figura 1: Produktiviteti në vendet e rajonit (output/\$ për orë të punuar)



Burimi: ILO 2005-2025



Tabela 1: Produktiviteti në vendet e rajonit (output/\$ për orë të punuar)

	Shqipëria	Bosnje & Hercegovina	Macedonia	Mali i Zi	Serbia
2005	10.64	15.45	22.68	27.97	17.42
2010	15.13	18.38	25.93	29.41	21.65
2015	17.94	21.87	27.43	27.29	23.83
2020	17.01	23.41	32.1	29.5	25.21
2025	19.5	26.47	33.56	37.49	28.8

Burimi: ILO 2005-2025

Kur analizojmë produktivitetin në \$ për orë pune të Shqipërisë me vendet e fundit të anëtarësuar në Bashkimin European, diferencat janë relativisht të mëdha. Bullgaria bashkë me Rumaninë edhe pse konsiderohen si dy nga vendet më të pazhvilluara që janë pjesë e BE-së, kanë norma relativisht më të larta produktiviteti për orë krahasuar me punonjësit në Shqipëri. Përkatësisht nga 19.5\$ që prodhon një orë punë në Shqipëri, në Bullgari një orë pune prodhon 36.22\$, kurse diferenca me Rumaninë është akoma më e madhe duke qenë se produktiviteti për orë pune atje është 52.13\$. Në Kroaci produktiviteti për orë punë është 58.05\$.

Mesatarja e Bashkimit European për produktivitetin për orë pune është 71.23\$ osë e thënë ndryshe mesatarisht një orë pune në Bashkimin European përkthehet në 51.8\$ më shumë për ekonominë krahasuar me Shqipërinë.

1.2 Produktiviteti në Shqipëri vs vendet e fundit të anëtarësuar në BE dhe mesatarja e BE


Grafiku 2: Produktiviteti në Shqipëri, mesataren e BE-së dhe vendet e fundit të anëtarësuar në BE (\$ për orë të punuar)**Burimi: ILO 2005-2025, përpunuar nga autori**

Tabela 2: Produktiviteti në Shqipëri, mesataren e BE-së dhe vendet e fundit të anëtarësuara në BE (\$ për orë të punuar)

	Shqipëria	Bullgaria	Kroacia	Rumania	BE
2005	10.64	22.1	36.8	25.61	57.11
2010	15.13	25.57	37.48	31.36	60.3
2015	17.94	27.93	42.56	36.79	63.96
2020	17.01	30.58	46.84	44.52	68.08
2025	19.5	36.22	58.05	52.13	71.32

Burimi: ILO 2005-2025, përpunuar nga autori

2. PRODUKTIVITETI SIPAS TË ARDHURAVE NETO TË KRIJUARA PËR PUNONJËS

Në këtë seksion do të analizohet produktiviteti i punonjësve duke u bazuar në të ardhurat neto të krijuara nga ata për kompaninë në të cilën punojnë. Analiza do të bëhet si ecuri ndër vite, do të realizohet për ndërmarrjet sipas numrit të punonjësve, si dhe sipas aktiviteteve ekonomike të këtyre ndërmarrjeve.

2.1 Produktiviteti i të ardhurave neto të ndërmarrjes sipas numrit të punonjësve

Për të analizuar më në detaje produktivitetin e punonjësve në Shqipëri të ndarë sipas ndërmarrjeve, sipas aktivitetit ekonomik dhe sipas numrit të të punësuarve, kemi marrë të ardhurat neto të krijuara nga ndërmarrjet si dhe numrin mesatar të punonjësve e kemi gjetur sa të ardhura neto krijohen në një vit nga një punonjës.


Rezulton që në Shqipëri një punonjës mesatarisht në një vit (2023) ka krijuar 6.04 milionë lekë (ose rreth 60,000 euro) për kompaninë në të cilën punon.

Produktiviteti më i ulët shfaqet në rastin e ndërmarrjeve të vogla, përkatësisht ato me 1-3 punonjës, ku përkatësisht një punonjës mesatarisht në një vit prodhon të ardhura neto për kompaninë 3.32 milionë lekë (ose rreth 33,000 euro).

Produktiviteti më i lartë shfaqet në ato ndërmarrje që kanë të punësuar 10-49 punonjës, ku të ardhurat vjetore mesatare të krijuara nga një punonjës arrijnë 7.97 milionë lekë (rreth 80,000 euro). Në kompanitë e mëdha me më shumë se 50 punonjës, një punëtor realizon të ardhura neto për kompaninë mesatarisht 6.79 milionë lekë në vit (ose rreth 68 mijë euro). Ndërkohë në kompanitë me 5-9 punonjës të ardhurat e gjeneruara nga një punonjës në një vit arrijnë 5.72 milionë lekë (ose rreth 57,000 euro).



Grafiku 3: Produktiviteti mesatar i një punonjësi në vit, sipas numrit të punonjësve për ndërmarrje, në milionë lekë, 2023




Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

2.2 Produktiviteti sipas viteve

Kur shikojmë produktivitetin përgjatë viteve 2010 deri në vitin 2023 rezulton që një punonjës prodhon në vitin 2023 më pak para për kompaninë ku punon krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2023 një punonjës mesatarisht krijon të ardhura neto të barabarta me 6.04 milionë lekë në vit ose rreth 503 mijë lekë në muaj, ndërkohë që në vitin 2022 mesatarisht krijonte rreth 6.13 milionë lekë në vit ose rreth 511 mijë lekë në muaj, pra rreth 1.5% më pak. Viti 2022 shënon edhe nivelin më të lartë të produktivitetit për punonjës në Shqipëri. Trendi gjatë viteve të marra në shqyrtim është rritës nga viti 2010 në vitin 2012, kurse nga viti 2013 deri në vitin 2016 kemi trend rënës. Në vitet 2017-2020 është qëndruar në po të njëjtat nivele krijimi të ardhurash për punonjës, ndërkohë që në vitin 2021 dhe 2022 është shënuar rritje e të ardhurave të krijuara nga një punonjës.



Grafiku 4: Produktiviteti në Shqipëri, të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit, milionë lekë, 2010-2023



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

2.3 Produktiviteti sipas aktivitetit ekonomik

Në këtë raport janë marrë në shqyrtim edhe niveli i të ardhurave mesatare të krijuara nga një punonjës sipas aktivitetit ekonomik në të cilin ai ushtron punën. Rezultoni që mesatarisht të ardhurat më të larta nga një punonjës krijohen në punët që lidhen me aktivitetin e tregtisë, ku përkatësisht një punonjës krijon të ardhura për kompaninë në të cilën punon përgjatë një viti rreth 11.23 milionë lekë (rreth 111 mijë euro). Pothuajse njësoj e kanë produktivitetin edhe punonjësit që punojnë në punë që kanë lidhje me energjinë elektrike, gazin, ujin dhe trajtimin e mbetjeve, ku përkatësisht një punonjës i këtij aktiviteti ekonomik realizon për kompaninë e tij mesatarisht përgjatë një viti rreth 11.06 milionë lekë (ose 110.6 mijë euro).

Aktivitetet e tjera kanë diferencë në krijimin e të ardhurave krahasuar me dy aktivitetet e përmendura më sipër. Aktiviteti i tretë ku një punonjës krijon më shumë të ardhura neto mesatarisht në një vit është industria nxjerrëse me përkatësisht 8.42 milionë lekë (ose 84.2 mijë euro). Diferenca me dy aktivitetet e para është rreth 2.64 milionë lekë ose rreth 26.4 mijë euro në vit për një punonjës.

Aktiviteti ekonomik në të cilin një i punësuar prodhon më pak të ardhura është akomodimi dhe shërbimi ushqimor, në të cilin një i punësuar mesatarisht krijon të ardhura neto për kompaninë e tij vetëm 2.16 milionë lekë ose rreth 21.6 mijë euro. Pak të ardhura neto për punonjës krijohen edhe në kompanitë të cilat operojnë në aktivitetin e shërbimeve. Në të dy këto aktivitete është e domosdoshme marrëdhënia njerëzore, prandaj është e kuptueshme që këto dy aktivitete janë ato që gjenerojnë të ardhurat më të ulëta për punonjës, e për pasojë produktiviteti është më i ulët.



Figura 5: Produktiviteti në Shqipëri, Të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit sipas aktivitetit ekonomik, në milionë lekë, 2023



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

2.4. Produktiviteti sipas aktivitetit ekonomik dhe numrit të punonjësve për ndërmarrje

Në këtë seksion kemi shikuar të ardhurat neto mesatare të krijuara nga një punonjës gjatë një viti sipas secilit aktivitet ekonomik dhe sipas numrit të punonjësve për ndërmarrjet.

Produktiviteti më i lartë përlogaritet tek punonjësit të cilët punojnë në ndërmarrjet me 1-4 punonjës që janë të përfshirë në aktivitetin e energjisë elektrike, gazit, ujit dhe trajtimit të mbetjeve. Përkatesisht, një punonjës mesatarisht në ndërmarrjet të cilat kanë 1-4 punonjës në aktivitetin e energjisë elektrike, gazit, ujit dhe trajtimit të mbetjeve krijon rreth 37.72 milionë lekë (ose 377.2 mijë euro) në vit. Niveli i dytë më i lartë i të ardhurave të krijuara mesatarisht nga një punonjës përgjatë një viti është përsëri në ndërmarrjet që punojnë në këtë aktivitet ekonomik, por që kanë 10-49 punonjës. I çuditshëm është fakti që tek i njëjti aktivitet ekonomik, por tek ndërmarrjet që kanë nga 5-9 punonjës dhe tek ato që kanë mbi 50 punonjës të deklaruar, kemi relativisht më pak të ardhura të krijuara mesatarisht nga një punonjës krahasuar me ndërmarrjet me 1-4 apo 10-49 punonjës. Kjo të paktën përsa i përket të dhënave të referuara nga INSTAT dhe matura nga ky institucion.


Tek aktivitetet ekonomike të "Tregtisë", "Transportit, Informacionit dhe Komunikimit", "Akomodimit dhe Sigurimit Ushqimor", si dhe "Industrië Nxjerrëse" vihet re një tendencë që me rritjen e numrit të punonjësve,



kemi edhe rritjen e të ardhurave të krijuara mesatarisht nga një punonjës, për kompaninë e tij. Kjo nënkupton një rritje normale, ku kompanitë e mëdha kanë realizuar më shumë investime qoftë në trajnime, qoftë në teknologji, duke rritur kështu produktivitetin e punonjësve.

Ndërkohë produktiviteti në aktivitetet e tjera ekonomike duket normal, ku në ndërmarrjet deri në 50 punonjës kemi rritje të produktivitetit me rritjen e punonjësve, ndërkohë që për ndërmarrjet mbi 50, kemi një nivel të produktivitetit më të ulët krahasuar me ata me më pak punonjës, por përsëri nuk është aq i ndryshëm dhe nuk kemi një ulje të ndjeshme.

Figura 6: Produktiviteti në Shqipëri, të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit sipas aktivitetit ekonomik dhe numrit të punonjësve, në milionë lekë, 2023



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

3. PRODUKTIVITETI DHE KOSTOT NË SHQIPËRI SIPAS AKTIVITETEVE EKONOMIKE NDËR VITE


Në këtë seksion do të analizojmë të ardhurat e krijuara mesatarisht nga një punonjës sipas aktivitetit ekonomik, duke marrë në shqyrtim vitet 2010-2023. Po njësoj do të shikohet edhe kostoja mesatare e një kompanie për një të punësuar (me ose pa pagë) përgjatë një viti. Kjo për të shikuar se çfarë po ndodh si me produktivitetin, por edhe me kostot e një kompanie.

3.1 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik “Prodhuesit e të mirave”

Produktiviteti në aktivitetin ekonomik “Prodhuesit e të mirave” ka shënuar rritje në vitin 2021 dhe 2022, ndërkohë që në vitin 2023 është shënuar një rënie krahasuar me një vit më parë. Nga vitin 2016 deri në vitin 2020, ndryshimet në produktivitetin e punonjësve janë shumë të ulëta dhe pothuajse të parpërfillshme, ku një punonjës mesatarisht krijonte të ardhura të njëjta vjetore për kompaninë në të cilën ai punonte gjatë këtyre viteve.

Përsa i takon kostove të llogaritura si shpenzime të personelit për kompaninë kundrejt numrit të punonjësve, rezulton që ato kanë shënuar rritje përgjatë viteve, ku përkatësisht në vitin 2023 kemi një rritje të tyre me 13.6%, duke arritur në 0.72 milionë lekë ose 7200 euro për punonjës në vit.


Figura 7: Produktiviteti i punonjësve në aktivitetin ekonomik “Prodhuesit e të mirave” (të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit



Figura 7.1 Kosto e punonjësve në aktivitetin ekonomik “Prodhuesit e të mirave” (Shpenzime Personeli për punonjës në një vit), në milionë lekë




Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

3.2 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik “Industria nxjerrëse”

Në industrinë nxjerrëse produktiviteti për punonjës ka shënuar luhatje përgjatë viteve të marra në shqyrtim. Produktiviteti më i lartë është arritur në vitin 2022 dhe pastaj në vitin 2014. Në vitin 2023 një punonjës mesatarisht ka krijuar të ardhura për kompaninë në të cilën ai punon rreth 22% më pak. Kostot e punonjësve kanë shënuar rritje të vazhdueshme pas vitit 2019. Në vitin 2023, kostoja mesatare për një punonjës me ose pa pagë në këtë aktivitet ekonomik rezulton rreth 1.33 milionë lekë ose rreth 13.3 mijë euro në vit.


Figura 8: Produktiviteti i punonjësve në Aktivitetin Ekonomik “Industria nxjerrëse” (të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit



Figura 8.1 Kosto e punonjësve në aktivitetin ekonomik “Industria nxjerrëse” (Shpenzime Personeli për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit


3.3 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik “Industria përpunuese”

Tendenca e produktivitetit të punonjësve në aktivitetin e industrisë përpunuese ka qenë në rritje në vitet 2021 dhe 2022, por ka pësuar një rënie të lehtë gjatë vitit 2023.

Ndërkohë kostot për një punonjës për kompanitë që zhvillojnë këtë aktivitet ekonomik kanë vazhduar që të rriten edhe në vitin 2023, duke arritur në vlerën e 0.66 milionë lekë ose rreth 6600 euro në vit për punonjës. Vlerat rezultojnë jo shumë të larta dhe kjo vjen për shkak se në kompanitë e vogla një pjesë e rëndësishme e tyre janë të regjistruar si punonjës pa pagë, që automatikisht ulin kostot për punonjës. Gjithsesi kostoja për punonjës na tregon nëse kostoja është në tendencë rritëse apo rënëse si dhe sa i kushton një kompanie mesatarisht një punonjës i deklaruar.


Figura 9: Produktiviteti i punonjësve në aktivitetin ekonomik “Industria përpunuese” (të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit), në milionë lekë, 2023





Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

Figura 9.1 Kosto e punonjësve në aktivitetin ekonomik “Industria përpunuese” (Shpenzime Personeli për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit


3.4 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik “Energji elektrike, gaz, ujë dhe trajtimi i mbetjeve”

Produktiviteti në aktivitetin e energjisë elektrike, gazit, ujit dhe trajtimit të mbetjeve ka shënuar pikun e tij në vitin 2022 me një rritje prej rreth 52% nga viti 2021, pastaj ka shënuar rënie në vitin 2023 me rreth 25%. Rritja e produktivitetit ka ardhur edhe si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë elektrike si pasojë e luftës Ukrainë-Rusi.

Nga ana tjetër kostot për një punonjës kanë shënuar rritje edhe në vitin 2023 duke arritur në rreth 0.91 milionë lekë ose rreth 9100 euro kosto vjetore për punonjës. Gjithsesi në këtë aktivitet ekonomik kthimi nga një punonjës është relativisht i lartë, pasi punonjësi prodhon të ardhura për kompaninë në vlerën e rreth 110 mijë euro, ndërkohë që kostoja e tij është vetëm 9100 euro në vit.




Figura 10: Produktiviteti i punonjësve në aktivitetin ekonomik “Energji elektrike, gaz, ujë dhe trajtimi i mbetjeve” (të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

Figura 10.1 Kosto e punonjësve në aktivitetin ekonomik “Energji elektrike, gaz, ujë dhe trajtimi i mbetjeve” (Shpenzime Personeli për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

3.5 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik “Ndërtimi”


Ndërtimi është një nga nënsektorët më të rëndësishëm ekonomik së bashku me turizmin në vitet e fundit për shkak të peshës së rëndësishme të tyre në prodhimin e brendshëm bruto dhe përkatësisht në peshën që kanë në rritjen ekonomike. Produktiviteti i një të punësuar në ndërtim ka shënuar rritje nga viti 2021 deri në vitin 2023, duke arritur të gjenerojë 6.28 milionë lekë, ose 62.8 mijë euro të ardhura neto mesatare vjetore të krijuara nga një punonjës.

Ndërkohë informaliteti i lartë në këtë sektor ka qenë dhe vazhdon që të jetë një komponent i rëndësishëm, i cili ndikon në numrin e punonjësve, si dhe në nëndeklarimin e pagave. Një punonjës i këtij aktiviteti ekonomik i kushton kompanisë së tij mesatarisht rreth 0.65




milionë lekë ose rreth 6500 euro në vit. Pra, kemi përafërsisht gjenerim të ardhurash sa 10 fishi i kostos së një punonjësi, ose e thënë ndryshe një punonjës prodhon të ardhura për kompaninë në të cilën punon 10 herë sa kostoja e tij për kompaninë.

Figura 11: Produktiviteti i punonjësve në aktivitetin ekonomik “Ndërtimi” (të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

Figura 11.1 Kosto e punonjësve në aktivitetin ekonomik “Ndërtimi” (Shpenzime Personeli për punonjës në një vit), në milionë lekë




Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

3.6 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik “Prodhuesit shërbimeve”

Produktiviteti në aktivitetin ekonomik të prodhimit të shërbimeve ka shënuar rritje në vitet 2020-2023. Pra në vitet e fundit në këtë aktivitet është shënuar rritje e vazhdueshme e produktivitetit, edhe pse në vitin 2023 rritja është minimale. Kur shikojmë kostot e punonjësve në këtë aktivitet ekonomik rezulton që ato kanë shënuar rritje përgjatë të gjithë periudhës së marrë në shqyrtim, nga viti 2010 deri në vitin 2023. Në vitin 2023 kostoja mesatare e një punonjësi në vit është rreth 0.67 milionë lekë ose rreth 6700 euro.




Figura 12: Produktiviteti i punonjësve në aktivitetin ekonomik “Prodhuesit e shërbimeve” (të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

Figura 12.1 Kosto e punonjësve në aktivitetin ekonomik “Prodhuesit e shërbimeve” (Shpenzime Personeli për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

3.7 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik “Tregtia”


Produktiviteti në aktivitetin e tregtisë është i dyti më i lartë ndër të gjitha aktivitetet. Që nga viti 2017, produktiviteti ka ardhur në rritje të vazhdueshme, ku rritja më e lartë është shënuar në vitin 2022.

Ndërkohë kur shikojmë kostot e një punonjësi sipas deklarimeve, rezulton që kostot janë relativisht ndër më të ulëtat edhe pse ato kanë ardhur në rritje të vazhdueshme ndër vite. Në vitin 2023 kostoja mesatare vjetore e një të punësuarit me ose pa pagë rezultonte rreth 0.58 milionë lekë ose rreth 5800 euro. Në sektorin e tregtisë një punonjës mesatarisht krijon të ardhura neto për kompaninë në të cilën punon sa 19 fishi i koston që ka kompania për atë punonjës. Këtu duhet të kemi




parasysh edhe informalitetin dhe një pjesë e të punësuarve janë të punësuar familjarë, pra pa pagë, sidomos në ato aktivitetet me pak punonjës.

Figura 13: Produktiviteti i punonjësve në Aktivitetin Ekonomik “Tregtia” (të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

Figura 13.1 Kosto e punonjësve në Aktivitetin Ekonomik “Tregtia” (Shpenzime Personeli për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit


3.8 Produktiviteti dhe Kosto në aktivitetin ekonomik “Akomodimi dhe shërbimi ushqimor”

Produktiviteti në aktivitetin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor është ndër më të ulëtët ku gjenerohen mesatarisht të ardhura prej vetëm 2.16 milionë lekë ose 21.6 mijë euro në vit nga një punonjës. Nga viti 2021 e mbrapa produktiviteti ka shënuar rritje pozitive, duke shfaqur një tendencë rritëse.

Kostot për punonjës në këtë aktivitet janë po ashtu më të ulëtët ku në vitin 2023 kostoja mesatare vjetore për një punonjës rezulton vetëm 0.45 milionë lekë, ose 4500 euro. Pavarësisht që kostoja është e ulët, ndër vite shfaq trend rritës.




Figura 14: Produktiviteti i punonjësve në aktivitetin ekonomik “Akomodimi dhe shërbimi ushqimor” (të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

Figura 14.1 Kosto e punonjësve në aktivitetin ekonomik “Akomodimi dhe shërbimi ushqimor” (Shpenzime Personeli për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

3.9 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik “Transporti, informacioni dhe komunikacioni”


Produktiviteti në aktivitetin e transportit, informacionit dhe komunikimit ka shënuar luhatje përgjatë viteve. Në disa vite kemi rritje, ndërkohë që në disa të tjera kemi rënie të produktivitetit. Në vitet nga 2020 deri në vitin 2022 kemi rritje të produktivitetit ndërkohë që në vitin 2023 kemi një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2022. Në këtë aktivitet një punonjës gjeneron të ardhura mesatare vjetore rreth 5.17 milionë lekë ose rreth 51.7 mijë euro.

Kostot e një punonjësi në këtë aktivitet kanë shënuar rritje të vazhdueshme që nga viti 2017 dhe deri në vitin e fundit të marrë në shqyrtim, 2023. Në vitin 2023, kostoja mesatare vjetore për një punonjës në këtë aktivitet rezultonte rreth 0.98 milionë lekë, ose rreth 9800 euro.




Kjo nënkupton që në këtë sektor një punonjës prodhon të ardhura për kompaninë ku ai punon sa 5-fishi i kostos së tij.

Figura 15: Produktiviteti i punonjësve në aktivitetin ekonomik “Transporti, informacioni dhe komunikacioni” (të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

Figura 15.1 Kosto e punonjësve në aktivitetin ekonomik “Transporti, informacioni dhe komunikacioni” (Shpenzime Personeli për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

3.10 Produktiviteti dhe kostot në aktivitetin ekonomik “Shërbimet”


Në aktivitetin e shërbimeve produktiviteti është relativisht i ulët, por ka shënuar disa hapa pozitive në dy vitet e fundit të marra në shqyrtim, 2022 dhe 2023. Në vitin 2023 në shërbime ka krijuar mesatarisht në vit vetëm 2.99 milionë lekë për kompaninë e tij, ose rreth 29,900 euro në vit.

Krahas rritjes së produktivitetit janë rritur edhe kostot për punonjës, përkatësisht që nga viti 2018, por përsëri duke qëndruar në nivele jo të larta. Kostoja mesatare e një punonjësi në këtë aktivitet ekonomik përgjatë vitit 2023 rezulton që të jetë rreth 0.74 milionë lekë ose rreth




7400 euro. Nga kjo rezulton që në këtë aktivitet një punonjës prodhon të ardhura për kompaninë e tij sa 4-fishi i kostos së tij.

Figura 16: Produktiviteti i punonjësve në aktivitetin ekonomik “Shërbimet” (të ardhura mesatare neto të krijuara për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit

Figura 15.1 Kosto e punonjësve në aktivitetin ekonomik “Shërbimet” (Shpenzime Personeli për punonjës në një vit), në milionë lekë



Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit



GJETJET KRYESORE

Produktiviteti është një indikator që vlerësohet çdo vit nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, përcaktuar si output i krijuar për një orë nga një punonjës. Rezulton që në Shqipëri produktiviteti për një punonjës në Shqipëri është vetëm 19.5\$ për orë pune. Ky është niveli më i ulët në rajon përsa i përket nivelit të produktivitetit, duke qëndruar edhe pas Bosnjë Hercegovinës me rreth 7\$ më pak. Vendi me normën më të lartë të produktivitetit të vlerësuar nga ILO për vitin 2025 është Mali i Zi, ku një punonjës prodhon rreth 37.5\$ për orë.

Rezulton që në Shqipëri produktiviteti më i lartë në tërësi është në rastin e ndërmarrjeve me 10-49 punonjës, ku një punonjës krijon 9.97 milionë lekë, ose rreth 100 mijë euro të ardhura neto për kompaninë në të cilën ai punon përgjatë një viti. Në total, mesatarisht një i punësuar ka një produktivitet prej 6.04 milionë lekë në vit, ose rreth 60,000 euro. Tendenca e produktivitetit duket rritëse me rritjen e numrit të punonjësve deri në ndërmarrjet me 50 punonjës, ndërkohë që për ndërmarrjet me mbi 50 punonjës, shfaqet dobja marxhinale rëndëse, ku me rritjen e numrit të punonjësve bie produktiviteti.

Deri në vitin 2021, produktiviteti ka qëndruar në po të njëjtat shifra, ndërkohë që në vitet 2021 dhe 2022 ka shënuar përmirësime, përmirësime këto që nuk janë ndjekur në vitin 2023, vit i cili ka shënuar rënie krahasuar me vitin e kaluar.

Aktiviteti ekonomik i tregtisë është ai në të cilin krijohen të ardhurat më të larta neto për punonjës përgjatë një viti, përkatësisht në vitin 2023, produktiviteti rezulton rreth 11.23 milionë lekë ose rreth 112.3 mijë euro. Aktiviteti ekonomik i dytë me produktivitetin më të lartë për punonjës është "Energjia elektrike, gazi, uji dhe trajtimi i mbetjeve", aktivitet i cili prodhon 11.06 milionë lekë ose rreth 110.6 mijë euro për punonjës gjatë një viti. Aktivitetet ekonomike që kanë një produktivitet më të ulët krahasuar me të tjerët janë "Akomodimi dhe siguria ushqimore" dhe "Shërbimet" me përkatësisht të ardhura neto për punonjës në vit 2.16 dhe 2.99 milionë lekë, ose 21.6 mijë dhe rreth 30 mijë euro në vit për punonjës.

Ndërmarrjet që kanë 1-4 punonjës në aktivitetin e "Energjisë elektrike, gazit, ujit dhe trajtimit të mbetjeve" janë ato që kanë një produktivitet më të lartë, me përkatësisht 37.72 milionë lekë ose rreth 377 mijë euro në vit për punonjës.

Rezulton që përgjithësisht ecuria për secilin nga aktivitetet ekonomike ka qenë pozitive në rritjen e produktivitetit në vitet 2021 dhe 2022, por jo në të gjitha aktivitetet është shënuar rritje gjatë vitit 2023. Në aktivitetet e "prodhuesit e të mirave", "Industria nxjerrëse", "Industria përpunuese", "Energjia elektrike, gazi, uji dhe trajtimi i mbetjeve", si



dhe në "Transport, informacion dhe komunikacion" kemi një rënie të produktivitetit gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë ajo çfarë ka ndodhur me kostot për punonjës është që ato kanë shënuar rritje përgjatë 3 viteve të fundit të marra në shqyrtim për të gjitha aktivitetet ekonomike. Kosto më e lartë për punonjës është në "industrinë nxjerrëse" me përkatësisht 1.33 milionë lekë ose rreth 13.3 mijë euro në vit për punonjës, dhe në aktivitetin e transportit, informacionit dhe komunikacionit ku kosto vjetore për punonjës është 0.98 milionë lekë ose rreth 9800 euro në vit. Kostot mesatare vjetore për punonjës shfaqen më të ulëta në aktivitetin e akomodimit dhe sigurimit shoqëror.

Si përfundim, duke shikuar të gjithë indikatorët e produktivitetit tregohet që produktiviteti në Shqipëri është shumë larg vendeve të BE-së por jo vetëm, sepse Shqipëria ndodhet e fundit edhe në rajon me diferencë të lartë edhe me shtete që janë më larg sesa Shqipëria në proceset e integritimit në BE siç është Bosnje & Hercegovina. Po ashtu, shikohet që edhe produktiviteti i matur si të ardhura neto vjetore për punonjës tregon që ka diferenca të larta midis sektorëve ekonomik, ndërkohë që pagat nuk shikohen që të kenë diferenca aq të larta (kostot në këtë rast). Produktiviteti i ulët për punonjës nuk lejon që të zhvillohet ekonomia në mënyrë natyrale dhe afatgjatë, duke sjellë edhe probleme me pagat e ulëta dhe probleme që vijnë si rrjedhojë, siç janë emigrimi.



REKOMANDIME

- Ndjekja e politikave publike që nxisin produktivitetin për të arritur mesataren e rajonit si fillim dhe pastaj të synohen vendet e fundit të aderuar në Bashkimin Europian.
- Përmirësimi teknologjik në të gjithë sektorët e ekonomisë për të rritur produktivitetin për punonjës, duke sjellë kështu më shumë të ardhura neto për kompaninë.
- Nxitja e trajnimeve në punë për të aftësuar punonjësit e për pasojë duke ndikuar drejtëpërdrejtë në rritjen e produktivitetit.
- Investimet në arsim për të rritur nivelin e kapitalit human në vend.
- Një lidhje më e fortë e universitetit dhe tregut të punës. Duke sjellë punonjësit më afër tregut të punës ata do të rrisin aftësitë dhe për pasojë produktivitetin. Këtu duhet të përfshihen edhe studime mbi tregun e punës se çfarë profesione shpesh kërkohen në treg dhe se cilat janë mundësitë e tregut shqiptar për t'u zhvilluar.

REFERENCA

ILO: <https://ilostat.ilo.org/>

INSTAT: <https://databaza.instat.gov.al:8083/pxëeb/sq/DST>



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al